

volumi 3, numri 1
Pranverë 2005

Zëri i

Gruas Kosovare

77

Në muajin prill, numri i anëtareve të regjistruara në Rrjetin e Grupeve të Grave të Kosovës (RRGGK) arriti në 77. Kjo e bën RRGGK-në rrjetin më të madh aktiv të organizatave joqeveritare (OJQ), jo vetëm në Kosovë, por edhe në tërë rajonin.

Anëtares e RRGGK-së përfaqësojnë llojllojshmëri të komuniteteve, rajoneve gjeografike dhe fushave të interesimit. Individualisht, ato punojnë për çështjeje siç janë shëndeti, mbrojtja e ambientit, arsimimi, ligji, parandalimi i trafikimit të femrave, ndihma humanitare, fëmijët dhe rinia, të drejtat e grave, parandalimi i dhunës ndaj grave, arti dhe kultura, zgjidhja e konflikteve, zhvillimi ekonomik dhe hapja e vendeve të reja të punës si dhe shërbime për nevoja të veganta.

Si rrjet, ato janë bashkuar për të avokuar për kalimin e mekanizmave të barazisë gjinore në nivelin qendror, për rritjen e vetëdijes publike lidhur me të drejtat në këtë legjislacion, për ngritjen e zërit kundër dhunës ndaj grave dhe shumë gjëra tjera.

Për informata më të hollësishme rreth anëtareve të Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës, ju lutemi që ta vizitoni faqen tonë të internetit:

www.womensnetwork.org.

Përmbajtja

- 2 Implementimi i Rezolutës 1325
- 2 LGK avokon për Përfshirjen e Grave
- 2 Shenimet nga Takimi i RRGGK në shkurt
- 3 "Me Leje, ju lutem" - Jeto Jetën
- 3 Konferenca "Beijing +10" në Nju Jork
- 3 Shenimet nga Takimi i RRGGK në prill
- 4 Promovimi i hulumtimit "Zëri i grave"
- 4 Motrat Qiriazzi New York Mirënjohje Kosovareve

Njohtimet

Koncerti "Te njohim te drejtat" në Prishtinë.....25 nëntor

Takimi i përdymuajshëm i RRGGK.....HCIC, 6 qershor, ora 11:00



Anëtares e RRGGK-së në takimin e tyre të fundit koordinues.

RRGGK takohet me Kryeministrin

6 prill, Prishtinë. Bordi dhe drejtorja e RRGGK-së u takuan me kryeministrin Bajram Kosumi. Në takim u diskutua për implementimin e Planit Veprues për arritjen e Barazisë Gjinore nga ana e qeverisë, për zyrën e kryeministrit për Barazi Gjinore, si dhe përfshirjen e grave në negociatat për statusin përfundimtar politik të Kosovës.

Përfaqësueset e RRGGK-së në fillim të takimit ia përkujtuar kryeministrit se ato janë duke i monitoruar hapat e Qeverisë drejt implementimit të Planit Veprues për arritjen e Barazisë Gjinore në Kosovë. Plani i cili është miratuar nga qeveria në vitin 2004, përfshirë hapat që duhet t'i ndërmerr qeveria lidhur me çështjet si arsimimi, shëndetësia, ekonomia, kultura, dhuna ndaj grave, përfshirja politike. Përveç rritjes së barazisë

gjinore në Kosovë, plani gjithashtu i kontribuon standardeve të cilat Kosova duhet t'i përbushë në mënyrë që të mund të diskutohet statusi i saj politik. Prandaj, përfaqësuesja e RRGGK-së theksoi se përkushtimi i qeverisë për implementimin e planit lidhet drejtpërdrejt me përbushjen e standardeve.

Çështja e dytë e cila u diskutua në takim gjithashtu kishte të bënte me standardet. Një veprim të cilin qeveria duhet ta ndërmarrë në aspektin e standardeve është implementimi i ligjit për gjininë. Sipas këtij ligji, nga qeveria kërkohet që ta formojë një Zyrë për Barazi Gjinore brenda Zyrës së Kryeministrit. Në këtë takim, delegacioni i RRGGK-së sugjeroi që qeveria ta formojë këtë zyrë si një agjenci ekzekutive brenda Zyrës së Kryemi-

nistrit dhe që stafi udhëheqës të jetë civil si kundërpeshë ndaj përfaqësuesve të partive politike. Në muajin maj, qeveria do të vendosë për mënyrën në të cilën do të krijohet kjo zyrë dhe kush do ta udhëheqë atë.

Së treti, bisedimet për statusin e ardhshëm politik të Kosovës do të fillojnë në vjeshtë të këtij viti. Në takim u bë fjalë për nevojën që të formohet një forum për negociatat e statusit final politik të Kosovës. Në bazë të rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, gratë duhet të përfshihen në këtë delegacion. Gjatë takimit me kryeministrin, delegacioni i RRGGK-së potencoi faktin se gratë duhet të jenë të pranishme në këtë këshill, në mënyrë që e tërë Kosova të përfaqësohet në bisedimet për statusin final.

RRJETI I GRUPEVE TË
GRAVE TË KOSOVËS



KOSOVA WOMENS
NETWORK

www.womensnetwork.org

Shënime nga takimi i RRGK në muajin shkurt

• Një artikull i gazetës "Lajm" përgojo punën e "Shtëpisë së sigurt" në Gjakovë duke mos u bazuar në fakte. "Lajm" tetë herë kishte kërkuar të bëjë intervistë por "Shtëpia e sigurt" nuk i kishte dhënë leje për t'i zhvilluar intervistat duke dashur që ta mbrojë anonimitetin e shtëpisë së sigurt dhe grave të cilat strehohen aty. Prapëseprapë, gazeta e botoi artikullin. RRGK-së dhe partnerët e saj reagon duke i dërguar letër të gjitha mediave dhe Komisionerit për media. "Lajm" kërkoi falje publikisht. I falënderohemi organizatave lokale dhe atyre ndërkombëtare për përkrahjen e tyre dhe nënshkrimin e letrës.

• "Gratë me aftësi të kufizuara" nga Prizreni dëshiruan që të bëjnë një organizim me rastin e 8 marsit për ç'gjëju nevojiten 200 euro. Anëtarët e RRGK-së e treguan solidaritetin e tyre duke dhënë të holla gjatë takimit.

• "Gratë Propozojnë" ka për qëllim që t'i ndërlidhë përfaqësueset e zgjedhura të grave dhe qytetarët. Fushata ka përfshirë më shumë se 1,000 pjesëmarrës.

• Qendra Kosovare për Studime Gjinore i ftoi anëtarët që t'i shfrytëzojnë botimet e reja Doracakun e OJQ-ve të Grave në Kosovë, Bibliografinë e Lëvizjes së Grave në Kosovë dhe Përmbledhjen e Studimeve Gjinore, në gjuhën shqipe.

• Ligji për Planifikimin Hapësinor në Kosovë është miratuar në shtator të vitit 2003, bazuar në të, komunat duhet t' përgatisin planet gjatë muajve të ardhshëm. Për ta siguruar pjesëmarrjen e qytetarëve në këtë proces, UN HABITAT planifikon që të organizojë takime me OJQ-të në dhjetë komuna.

• Organizata Mental Disability Rights International është duke e mbikëqyre situatën e personave me aftësi të kufizuara mentale. Neni 20 i Ligjit për Familjen është diskriminues ndaj personave me aftësi të kufizuara mentale sepse nuk e lejon martesën e tyre. MDRI ka kërkuar që ky nen të ndryshohet.

A është implementuar Rezoluta 1325?

RRGGK përgatitë Konferencë Ndërkombëtare për Rezolutën 1325 në Kosovë

RRGGK-ja dhe Zene Zenama (Gratë për gratë) nga Sarajeva, me përkrahjen e UNIFEM-it, janë duke përgatitur një raport për nivelin në të cilin rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara është implementuar në Kosovë dhe Bosnje. Në tetor, në përvjetorin e pestë të miratimit të rezolutës, raporti do t'i paraqitet Këshillit të Sigurimit.

Rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, e

miratuar në vitin 2000, bëri që të drejtat për ceshtjen gjinore dhe të drejtat e grave të jenë prioritet në të gjitha përpjekjet që kanë për qëllim parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve, ndërtimin dhe ruajtjen e paqes dhe rehabilitimin.

Dy vjet më parë, u shfaq ideja për organizimin e një rrjeti të grave të rajonit për të punuar në implementimin e rezolutës 1325 të KS të KB. Besohej se, duke punuar së bashku, gratë do të mund të kishin një zë më

të fuqishëm në implementimin e saj. Takimi i parë u organizua në Prishtinë, në vitin 2004, me përkrahjen e UNIFEM-it.

"UNIFEM-i e konsideron të rëndësishme e përkrahjen e përpjekjeve lokale për

mbikëqyrjen e përparimit aktual dhe zhvillimin e planeve konkrete për avancimin e implementimit të plotë të rezolutës," tha në një letër zyrtare Osnat Lubrani, drejtore e programit regional të UNIFEM-it për Evropën Qendrore dhe Lindore.

Në muajin mars 2006, RRGK-ja do të organizojë një konferencë ndërkombëtare në Kosovë për të diskutuar lidhur me punën e grave të rajonit në implementimin e rezolutës 1325 të KS të KB. Gratë kosovare do t'i ftojnë gratë e vendeve post-konfliktuale nga e tërë bota. Gratë nga Kosova dhe ato nga Bosnja do të japin informacione për rezolutën 1325 të KS të KB, mësimet e fituara nga përvojat e tyre dhe kështilla lidhur me atë se si gratë e vendeve tjera post-konfliktuale do të mund të fillonin punën në implementimin e menjëherëshëm të rezolutës.

Gratë që do të marrin pjesë në konferencë do ta kthehen në vendet e tyre me një draft raport për implementimin e rezolutës 1325 të KS të KB.



RRGGK, Zene Zenama, Antico dhe UNIFEM diskutojnë raportin për përparimin e bërë drejt implementimit të rezolutës 1325 të KS të KB. Angela McKay e moderon diskutimin.

LGK kërkon: Gratë të Përfshihen në Bisedimet për Statusin

Lobi i Grave të Kosovës (LGK) i dërgoi një letër qeverisë dhe parlamentit me anë të së cilës kërkoi që gratë të marrin pjesë në bisedimet lidhur me statusin final politik të Kosovës, që janë

paraparë të mbahen në vjeshtë të këtij viti (ju lutemi shikoni letërën më poshtë).

Kryeministri u përgjigj se kabineti i tij dhe ministrat janë të vetëdijshëm për rëndësinë e bashkëpunimit

me dhe këshillimit me akterët e shoqërisë civile, veçanërisht për arsye të përfitimit nga përvojat e tyre të mëparshme. Ai premtoi se qeveria e Kosovës do të këshillohet dhe do të punojë ngushtë me LGK-në në bisedimet rreth pavarësisë së Kosovës.

"Sugjerimet e juaja gjithmonë janë të mirëseardhura," tha ai në një letër dërguar LGK-së.

Më herët, LGK-ja i ka dërguar letër UNMIK-ut, me kërkesën që të jetë pjesë e dialogut Prishtinë-Beograd. Ndonëse disa gra janë përfshirë në procesin e deritashëm, LGK-ja kërkon që qeveria të përfshijë dhe të këshillohet edhe me më shumë gra.

LGK është një grup i grave lidere në politikë, shoqëri civile dhe sektorin privat, që angazhohen dhe përkrahin të menduarit kritik konstruktiv, si dhe veprimet strategjike dhe progresive që kanë të bëjnë me çështjet e rëndësishme të zhvillimit politik, shoqëror dhe ekonomik të Kosovës, veçanërisht të atyre që janë me interes për gratë. Pjesëmarrja në LGK është në baza individuale dhe anëtarët nuk i përfaqësojnë zyrtarisht institucionet në të cilat punojnë.

I nderuari zotëri,

Kohë më parë mësuam për iniciativën tuaj për formimin e një forumi përgjegjës për negociimin e statusit final të Kosovës. Ne e përkrahim këtë iniciativë dhe e konsiderojmë atë si një hap shumë të rëndësishëm drejt përfshirjes së të gjithë akterëve kryesorë politikë më marrjen e vendimeve për këtë çështje jashtëzakonisht të rëndësishme për të gjithë ne.

Zgjidhja e statusit të Kosovës është çështje vitale për të gjithë kosovarët dhe ajo do të ndikojë fuqimisht në përparimin politik, ekonomik dhe shoqëror të vendit tonë. Gratë, të cilat përbëjnë gjysmën e popullatës së Kosovës, janë të interesuara dhe kanë të drejtë që të marrin pjesë tërësisht dhe aktivisht në procesin e bisedimeve për statusin final të Kosovës. Për më tepër, gratë gjithmonë kanë qenë dhe ende janë aktere të rëndësishme në të gjitha aspektet e përpjekjeve të Kosovës për liri dhe pavarësi, veçanërisht gjatë 15 viteve të fundit. Prandaj, gratë mund dhe duhet t'i përfshijnë idetë, përvojën dhe energjinë e tyre në këtë proces të rëndësishëm të vendimmarrjes për të ardhmen tonë të përbashkët. Një-kohësisht, përfshirja e grave në bisedimet për zgjidhjen finale për paqe është dispozitë themelore e Rezolutës 1325 të KS të KB, e cila është e aplikueshme edhe në Kosovë.

Për këto arsye, Lobi i Grave të Kosovës kërkon që ju dhe institucionet politike të cilat do të vendosin për parimet dhe mekanizmat konkretë të krijimit të forumit për bisedimet rreth statusit, të krijojnë mundësi dhe të sigurojnë përfshirjen e barabartë dhe efektive të grave në këto struktura.

Ne e çmojmë lartë përkrahjen tuaj të vazhdueshme për iniciativat e shoqërisë civile në Kosovë dhe llogarim në përkrahjen tuaj energjike për të siguruar pjesëmarrjen e barabartë të grave në procesin kritik të vendosjes për statusin final të Kosovës.

Jetto Jetën thotë: "Me Leje, ju lutem"

"Jeto Jetën," asociacion i grave me aftësi të kufizuara, anëtare e RRGK-së, ka filluar një projekt avokimi të quajtur "Edhe ne kemi të drejtë për vendimmarrje." Ky asociacion është duke avokuar në Ministrinë e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit për ndryshimin e politikës së saj (Urdhëresa Administrative 2002/G-3) lidhur me licencimin e auto-shkollave në Kosovë. "Jeto Jetën" i ka sugjeruar ministrisë që ta shtojë një nen me të cilin do të kërkohet nga auto-shkollat që të kenë së paku një auttomjet të specializuar ashtu që edhe personat me aftësi të kufizuara fizike të kenë mundësi të vozisin. Mungesa e këtij neni në ligjin që aktualisht është në fuqi i privon personat me aftësi të kufizuara nga e drejta që të kenë një trajnim të përshtatshëm dhe t'i nënshtrohen provimit për marrjen e patentë-shoferit.

Sipas organizatës "Jeto Jetën," në

Kosovë jetojnë përafërsisht 140,000 persona me aftësi të kufizuara fizike. Të gjithë duhet të ballafaqohen me mungesën e ligjeve dhe rregullativave adekuate. Këta persona gjithashtu hasin në shumë pengesa gjatë realizimit të të drejtave themelore njerëzore.

"Jeto Jetën" është formuar në shkurt të vitit 2001. Ajo ka për qëllim ta fuqizojë dhe ta përkrahë pavarësinë e grave me aftësi të kufizuara.

Fondi për Iniciativë Demokratike e ka financuar këtë projekt përmes Projektit të Avokimit të OJQ-vë të Kosovës, që përkrahët nga East-West Management Institute dhe nga populli amerikan përmes USAID-it.



Duke pritur para shkallëve të ndërtesës komunale në Deçan - në Kosovë përafërsisht 140,000 persona me aftësi të kufizuara fizike ballafaqohen me pengesa në realizimin e të drejtave themelore njerëzore.

Mijëra Gra Mblidhen për "Beijing +10"

4 mars, Nju Jork. Pas një konference dyjavore në të cilën morën pjesë mijëra përfaqësues të organizatave qeveritare dhe joqeveritare nga e tërë bota, Komisioni për Statusin e Grave ripohoi Platformën e Pekinit për Veprim. Rezultatet do të prezantohen në sesionin e 60-të të Asamblesë së Përgjithshme.

Delegacioni i Kosovës ishte i përbërë nga Luljeta Vuniqi, Igballe Rogova, Sevdie Ahmeti dhe Femije Gashi, prej Zyrës së Kryeministrit për Barazi Gjinore.

Gjatë kësaj konference, përfaqësuesja e RRGK-së, Igballe Rogova foli në katër organizime.

Së pari, në pjesën e OJQ-ve, ku Urgent Action Fund e prezantoi raportin me titull "Rising Up in Response: Women's Rights Activism in Conflict," shkruar nga

Jane Barry, dhe në Misionin e Mbretërisë së Bashkuar në Kombet e Bashkuara, ngjarje kjo në të cilën morën pjesë delegatet që përfaqësonin gjashtë shtete në Kombet e Bashkuara. Në të dy ngjarjet, Igballe Rogova foli për mënyrën në të cilën organizatat ndërkombëtare i trajtojnë gratë dhe aktivistet lokale. Ajo gjithashtu paraqiti përvojat e Kosovës në implementimin e Rezolutës 1325, e cila bën thirrje për përfshirjen e grave në aktivitetet e ndërtimit të paqes.

Së dyti, Instituti për Shoqëri të Hapur mbajti një organizim të quajtur "Përppjekjet e Avokimit të Beijing +10 në Shtetet e Tranzicionit Post-socialist."

Së treti, "Women Waging Peace" organizoi një diskutim në të cilin foli



Ambasadorin Chowdhury

kur kishte ardhur si kryesues i delegacionit të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Në atë kohë, Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) pohoi se UNMIKu nuk u kishte siguruar kohe delegacionit për t'u takuar me gratë e Kosovës, mirëpo ai kishte kërkuar takim. Ambasadori Chowdhury, i cili ishte shumë i angazhuar në kalimin e Rezolutës 1325, tha se ishte i impresionuar me faktin se gratë e Kosovës tashmë janë duke e shfrytëzuar këtë rezolutë.

Igballe Rogova e falenderoi Ambasadorin Chowdhury, jo vetëm për shkak të përkrahjes së tij për aprovimin e kësaj rezolute por gjithashtu edhe për përkushtimin e tij që të shohë implementimin e saj, gjë që u vërtetua me anë të konsultimeve që ai pati me gratë e Kosovës.



Gratë nga vendet post-socialiste flasin për përvojat e tyre gjatë një takimi të organizuar nga Instituti për Shoqëri të Hapur në Nju Jork.

Shënime nga takimi i RRGK në muajin prill

- Udhëheqësja e departamentit për Barazi Gjinore në zyrën e Kryeministrit për Qeverisje të Mirë, Mundësi të Barabarta, të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore, raporto i lidhur me takimin e grave kosovare me Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm. Në këtë takim, ata diskutuan për krijimin e Zyrës për Barazi Gjinore.

- Faza e dytë e fushatës "Te njohim te drejtat," që sponsorizohet nga UNIFEM-i, filloi në mars me shfaqje në 20 komuna. Fushata do të përfundojë me 25 nëntor me një koncert të madh ku do të marrin pjesë artistë të njohur të rajonit.

- "Reforma," një koalicion i OJQ-ve që avokoi për ndryshime në sistemin zgjedhor të vitit 2004, u ribashkua. RRGK-ja, KIPRED-i dhe Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut janë duke e përpiluar një plan veprues dyvjeçar me përkrahje teknike të Institutit Kombëtar Demokratik (NDI) dhe UNIFEM-it. Ky plan do të prezantohet në një konferencë për shtyp.

- U prezantuan rezultatet e vlerësimit vjetor të anëtarëve të RRGK-së. Anëtarët votuan për vazhdimin e takimeve dymujore në Prishtinë.

- Me ndihmën e B.A.B.E, një OJQ e grave shqiptare ka filluar punën në Kroaci. RRGK-ja dërgoi një letër përkrahëse.

- Në zyrën e Ombudspersonit është formuar Njësia për Gjini.

- "Gratë me aftësi të kufizuara" nga Prizreni iu falënderuan RRGK-së për të hollat e dhëna në takimin e fundit për organizimin me rastin e 8 marsit.

- Qendra Kosovare për Studime Gjinore kërkoi nga OJQ-të që ta përkrahin hulumtimin e saj për historinë e grave kosovare në shoqërinë civile.
- Mental Disability Rights International bëri të ditur formimin e një grupi përkrahës për personat me pengesa mentale në Prizren dhe kërkoi nga anëtarët e RRGK-së që të fillojnë formimin e grupeve të ngjashme përkrahëse në komunat e tyre.

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

www.womensnetwork.org

rrggk_kwn@yahoo.com

+381 (0)38 245 850

Agim Ramadani Nr. 50/8

Prishtinë, Kosovë

Stafi i RRGK

Igballe Rogova

Drejtoresh Ekzekutive
igrogova@yahoo.com

Elita Gota

Menaxhere e Programit
elitagota@yahoo.com

Besa Shehu

Menaxhere e Financave
besa_shehu@yahoo.com

Bordi i RRGK

Naxhije Buçinca
Delina Fico
Luljeta Vuniqi
Marta Prekpalaj
Vjosa Dobruna
Belgjyza Muharremi
Behar Selimi

Motrat Qiriaz New York Mirënjohje Kosovareve

Gjate konferencës Beijing + 10 në New York, Motrat Qiriaz, shoqatë e grave Shqiptaro Amerikane, organizoi një manifestim për të festuar 8 marsin, Ditën Ndërkombetare të gruas. Gjate këtij manifestimi u shpërndanë mirënjohjet aktivistëve nga mbare bota, në mesin e të cilave Sevdie Ahmetit dhe Igballe Rogovës. Manifestimi vazhdoi me valle festive.

"Zëri i Gruas Kosovare"
është shkruar nga Elita Gota,
redaktuar dhe dizajnuar nga
Nicole Farnsworth.

www.womensnetwork.org

U promovua raporti: "Zëri i Grave"

Hulumtimi "Zëri i Grave" u promovua ne Ditën Ndërkombetare të Shëndetësisë. Reportin ne teresi mund ta lexoni ne webfaqen e Rrjetit: www.womensnetwork.org.

Permbledhja

Ndërsa shoqëria kosovare po kalon rrugën e vështirë të ndryshimit, cili është roli i grave në proces? A lejohen ato të drejtojnë apo detyrohen të binden? A kanë ato pushtetin për t'i marrë vendimet që u duhet të marrin për jetën e tyre dhe të familjeve të tyre? A kanë ato qasje të barabartë në arsim, raste pune dhe shërbime shëndetësore që të ndihmohen për të jetuar sa më mirë ato vetë dhe familjet e tyre?

Synimi i përgjithshëm i studimit ishte të gjindet nga vetë gratë, të të gjitha moshave, të gjitha kombësive dhe fushave të jetës, se cilat janë shqetësimet e tyre madhore dhe në çfarë aspektesh ato ndjehen sikur trajtohen jo barabartë ose që të drejtat e tyre nuk po respektohen. Studimi është veçanërisht unik sepse ai kërkon të dijë prej një pjese të gjërë të grave të zakonshme kosovare se çfarë mendojnë. Duke bërë kështu, ai synon të plotësojë dhe mbështesë punën e madhe që bëhet drejt aritjes së barazisë gjinore tashmë në Kosovë. Më veçanërisht, duke përpiluar, krahasuar dhe analizuar pikëpamjet e grave, ky raport synon të përforcojë përpjekjet e avokimit lidhur me Planin e Veprimit të Kosovës për Arritjen e Barazisë Gjinore, që u përfundua dhe u miratua në muajt e fundit nga një

brez i gjerë faktorësh qeveritarë dhe të shoqërisë civile.

Duke pranuar se organizatat e shoqërisë civile janë forcat shtytëse kyçe të punës aktuale mbi çështjet gjinore në Kosovë, hapi i parë në këtë ndërmarrje ishte të ftoheshin OJQ-të vendore të grave t'i bashkoheshin studimit në mënyrë që të jepnin këshilla dhe udhëzime mbi qasjen, mjetet e kërkimit dhe interpretimin e gjetjeve. Përfaqësueset të Rrjetit të Grave të Kosovës, Inicativës së Grave të Kosovës, Rrjetit të Grave Rome, Ashkali dhe Egjiptiane si dhe Rrjetit të Grave Serbe u përfshinë dhe ndihmuan shumë në stadin konceptual të studimit. Rrjeti i Grave të Kosovës, në veçanti, ka luajtur një rol thelbësor duke drejtuar zhvillimin e pyetësorit të studimit, udhëzuesit e fokus grupit dhe diskutimin e intervistave të hollësishme, e po ashtu edhe zhvillimin e këtij raporti.

Indeksi Kosova, një ndërmarrje e përbashkët me BBSS Gallup International dhe një kompani vendore kërkimi u angazhuan të zhvillonin mjetet e kërkimit dhe të zhvillonin mbledhjen e të dhënave si dhe analizën për studimin.

Ky raport synon gjithashtu të mbështesë qeverinë dhe popullin e Kosovës për të punuar drejt Synimeve zhvillimore të mijëvjeçarit .Këto janë tetë synime zhvillimore për të cilat 189 vende janë pajtuar të punojnë deri më 2015. Promovimi i barazisë gjinore dhe aftësimi i grave është i treti nga këto tetë synime, që përfaqëson domethënia

e tij sa i përket ndihmës në qëllimin e përgjithshëm të përmirësimit të jetesës për të gjithë.

Për studim janë shfrytëzuar këto metoda; rishikimi i literaturës relevante në mars/prill 2004, një hulumtim sasior në prill/maj 2004 duke përdorur një pyetësor dhe analizë cilësore në përmjet fokus grupeve dhe intervistave të hollësishme në korrik/gusht 2004.

Roli dhe Statusi Rekomandimet

o Integrimi i perspektives gjinore në politikat lidhur me të gjitha sferat e

shoqërisë.

o Përcaktimin e kushteve që marrin parasysh aspektet gjinore dhe nëse është e nevojshme edhe veprime të tjera pozitive me qëllim të shtimit të pjesëmarrjes së grave në pozitivat vendimarrëse.

o Modifikimi i orarit gjatë ditëve të punës për të përcaktuar periudhën 8-16 si orë të rregullta pune.

o Fuqizimi i grave në të gjitha rolet dhe nivelet në partitë politike.

o Rritja e numrit të grave në politikë dhe në qeveri.

Arsimi dhe Mundësitë Rekomandime

o Krijimi i një arsimit dhe mjedisi shoqëror që nuk ka stereotype të bazuara në gjini dhe diskriminim, si dhe që promovon qasjen e barabartë në arsim.

o Zhvillimi i veprimtarive për vetëdijësimin publik veçanërisht për vajzat e shkollave fillore dhe prindët e tyre.

o Organizimi dhe subvencionimi i transportimit për fëmijët fshatarë për t'u siguruar që ata mund të shkojnë të sigurtë të shkolla më e afërt tetëvjeçare.

o Përditësimi i programit aktual për të plotësuar nevojat e tregut vendor të punës dhe për t'i dhënë studentëve, veçanërisht vajzave, këshilla lidhur me opsionet për punësim.

o Rritja e qasjes së grave në kredi, huamarrje dhe bursa shkollimi.

Shëndetësia Rekomandime

o Sigurimi i qasjes së barabartë në kujdesin shëndetësor dhe shërbimet e mirëqenies sociale.

o Promovimi i arsimit publik dhe kërkimit mbi çështjet shëndetësore lidhur me gratë.

o Shtrirja e konceptit të "qendrës miqësore" dhe përforcimi i rregulloreve për të garantuar anonimatën e grave në diskutimet e tyre me profesionistët shëndetësor.

o Krijimi i mekanizmeve stimulues për t'i mbajtur profesionistët e kujdesit shëndetësor në sektorin publik.


o Zhvillimi i vazhdueshëm i profesionistëve shëndetësor me qëllim të përmirësimit të cilësisë në kujdesin shëndetësor ndaj grave.

o Krijimi dhe formulimi i standardeve për përmirësimin e cilësisë në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor.

o Akreditimi dhe certifikimi i shërbimeve shëndetësore që japin kujdes shëndetësor me cilësi të mirë.

o Zhvillimi i Strategjisë së Shëndetit Reproduktiv.

o Zhvillimi i programeve kombëtare për kontrollin rutinor të kancerit të gjirit dhe atij cervical.



Voice of Women